



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI  
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-030  
Prishtinë, më 14 maj 2018, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 14 MAJ 2018

**Në mbledhje morën pjesë:** Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Kujtim Shala, Aida Dërguti dhe Slavko Simiq, nënkryetarë të Kuvendit.

**Nga grupet parlamentare:** Armend Zemaj, Memli Krasniqi, Glauk Konjufca, Dardan Sejdiu, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

**Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit:** Avni Bytyqi dhe Valmir Klaiqi.

**Nga Administrata e Kuvendit:** Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj, Musli Krasniqi dhe Osman Shatri.

**Nga EUSR-ja:** Blerta Bejtullahu,

**Nga NDI-ja:** Shefki Kastrati,

**Nga OSBE-ja:** Sanije Berisha.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe shtatë (7) pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia e Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

### **Rend dite**

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Vazhdimi i seancës plenare me pikat e papërfunduara më 16, 17, 18, 20, 26 prill 2018 dhe më 3 maj 2018,
3. Përgatitjet për seancë plenare të radhës dhe
4. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

#### **1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme të Kryesisë së Kuvendit**

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 11 dhe 19 prill 2018.

#### **2. Vazhdimi i seancës plenare me pikat e papërfunduara më 16, 17, 18, 20, 26 prill 2018 dhe 3 maj 2018**

Kryesia, me pëlqimin e përfaqësueseve të grupeve parlamentare, vendosi që vazhdimi i seancave plenare të Kuvendit me pikat e papërfunduara të bëhet të mërkurën, më 23 maj 2018, në orën 10:00, me këtë:

### **Rend dite**

1. *Votimi i Projektligjit nr. 06/L-061 për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për transferimin e personave të dënuar,*
2. *Votimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e gjashtë (6) anëtarëve të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit,*
3. *Votimi i propozim-rezolutës nga debati parlamentar në lidhje me korrupsionin si kriter për liberalizim të vizave,*
4. *Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar në lidhje me sigurinë e fëmijëve në përdorimin e internetit në Kosovë,*
5. *Votimi i rekomandimeve nga Interpelanca në lidhje me reduktimet e ashpra të furnizimit me energji elektrike dhe situatën në sektorin e energjisë,*

6. *Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar në lidhje me Raportin e Progresit për Republikën e Kosovës,*

7. *Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, në lidhje me vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 02/34, datë 5. 3. 2018, për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej një milion euro për KOSTT-in për mbulimin e shpenzimeve të furnizimit me energji elektrike të katër komunave në veri të Kosovës,*

8. *Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupi Parlamentar Deputetët e Pavarur, në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjes komerciale ndërmjet kompanisë “Contour Global” dhe Qeverisë së Kosovës për projektin e Termocentralit “Kosova e Re”, të nënshkruar më 20 dhjetor 2017,*

9. *Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar në institucionet dhe zyrtarët e lartë të Republikës së Kosovës.*

### **3. Vazhdimi i seancës plenare me pikat e papërfunduara nga seanca më 3 maj 2018**

1. *Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për ekstradim,*

2. *Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për shkarkimin e nënkryetares së Kuvendit, znj. Aida Dërguti,*

3. *Votimi për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës.*

### **4. Përgatitjet për seancën plenare të radhës**

Kryesia e Kuvendit, me pëlqimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet të enjten, më 17 maj 2018, në orën 10:00, me këtë:

#### **Rend dite**

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*

2. *Koha për pyetje parlamentare,*

3. *Shqyrtimi i vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare,*

4. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99,*

5. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale,*

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-029 për tatimin në të ardhurat e korporatave,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-037 për Tatimin në Vlerën e Shtuar,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e konsumatorit,
10. Shqyrtimi i Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2018-2022,
11. Shqyrtimi i Strategjisë Shtetërore të Ujërave në Kosovë, 2017-2036,
12. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për Biodiversitetin 2016-2020,
13. Shqyrtimi i raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2017,
14. Shqyrtimi i raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017,
15. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2017,
16. Propozimi i Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare,
17. Zgjedhja e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Medieve,
18. Propozim-rezoluta për heqjen e roamingut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë,
19. Propozim-rezoluta për hapjen e tërësishme të kontrollit për hyrje-daljet e shtetasve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë nëpërmjet pikave të kalimit kufitar në Vërmicë, Qafë Prush dhe Qafë Morinë,
20. Debat parlamentar në lidhje me të drejtat e punëtorëve dhe adresimin e papunësisë në Republikën e Kosovës, sipas kërkesës së GP të LVV,
21. Debat parlamentar në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë për unifikimin e pikave doganore ndërmjet tyre, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, i mbështetur edhe nga 11 deputetë,
22. Debat parlamentar në lidhje me Kartonin e Gjellbër, sipas kërkesës së deputetit Faton Topalli, i mbështetur edhe nga 11 deputetë,
23. Debat parlamentar në lidhje me gjendjen jo të mirë të rinisë kosovare, sipas kërkesës së deputetit Fidan Rekalju, i mbështetur edhe nga 5 deputetë.

## **5. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave**

*1. Nisma legislative “Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-176 për Hetim Parlamentar”, hartuar nga nënkryetarja e Kuvendit Aida Dërguti, mbështetur nga 11 deputetë*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e nismës legislative për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-176 për hetim parlamentar, nxori këtë:

### **P Ë R F U N D I M**

Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me nismën legislative “Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-176 për hetim parlamentar”, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për

përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afatin prej një (1) muaji nga dita e pranimiit.

*2. Nisma legislative “Projektligji për peticione” hartuar nga deputetja Albulena Haxhiu, mbështetur edhe nga 10 (dhjetë) deputetë të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e nismës legislative për Projektligjin për peticione, nxori këtë:

#### P Ë R F U N D I M

Kërkoheh nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me nismën legislative “Projektligji për peticione”, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afatin prej një (1) muaji nga dita e pranimiit.

*3. Nisma legislative “Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për familjen i Kosovës” hartuar nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e nismës legislative për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për familjen i Kosovës, nxori këtë:

#### P Ë R F U N D I M

Kërkoheh nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me nismën legislative “Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për familjen i Kosovës”, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afatin prej një (1) muaji nga dita e pranimiit.

*4. Procedimi i Projektligjit për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e Projektligjit për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz, nxori këtë:

#### P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz u shpërndaheh deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkoheh Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, si komision funksional, që ta shqyrtojë Projektligjin në parim dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime, para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

*5. Propozim-rezoluta për heqjen e roamingut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë*

Kryetari i njoftoi të pranishmit me propozimin e deputetit Dardan Molliqaj, i mbështetur edhe nga 11 deputetë nënshkrues për miratimin e Propozim-rezolutës së lartshënuar.

Propozim-Rezolutën për heqjen e roamingut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë e arsyetoi kryetari i GP të PSD-së, Dardan Sejdiu, diskutimi i të cilit është i dhënë në transkript.

Lidhur me Propozimin-Rezolutën e lartcekur, diskutuan: Xhavit Haliti dhe Kujtim Shala, nënkryetarë të Kuvendit, si dhe Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së dhe Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve, Propozim-rezolutën për heqjen e roamingut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë e radhiti në rend dite për seancën plenare, më 17 maj 2018.

*6. Propozim-rezoluta për hapjen e tërësishme të kontrollit për hyrje/daljet e shtetasve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë nëpërmjet pikave të kalimit kufitar në Vërmicë, Qafë Prush dhe Qafë Morinë*

Gjithashtu, kryetari i njoftoi të pranishmit edhe me propozimin tjetër të deputetit Dardan Molliqaj, i mbështetur edhe nga 11 deputetë nënshkrues për miratimin e Propozim-rezolutës së lartshënuara.

Kryesia, Propozim-rezolutën për hapjen e tërësishme të kontrollit për hyrje/daljet e shtetasve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë nëpërmjet pikave të kalimit kufitar në Vërmicë, Qafë Prush dhe Qafë Morinë e radhiti në rend dite për seancën plenare, më 17 maj 2018.

*7. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2017*

Kryesia, pasi e shqyrtoi raportin e shpenzimeve të Kuvendit për viti 2017, mori këtë:

#### V E N D I M

Miratohet raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2017 sipas pasqyrave të paraqitura nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Administrata e Kuvendit.

*8. Propozimi i Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me emërimet e shërbyeseve të lartë civilë në Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës*

Kryesia, pasi e shqyrtoi propozimin e lartshënuar, nxori këtë:

## P Ë R F U N D I M

1. Kërkohej nga grupet parlamentare që deri në mbledhjen e radhës të Kryesisë t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit Hetimor Parlamentar sipas propozimit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me emërimet e shërbyeseve të lartë civilë në Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës.

2. Përbërja e komisionit do të jetë me 11 anëtarë: grupet parlamentare të LDK-së, të LVV-së dhe PSD-së propozojnë pesë (5) anëtarë, në mesin e tyre propozojnë kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin, si dhe grupet parlamentare të PDK-së, AAK-së, Listës serbe, Nisma Socialdemokrate dhe "6+" propozojnë gjashtë (6) anëtarë.

*9. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, mbështetur edhe nga deputetët tjerë nënshkrues, për formimin e Komisionit hetimor parlamentar, në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq më 29 mars 2018*

Kryesia, pasi e shqyrtoi propozimin e lartshënuar, nxori këtë:

## P Ë R F U N D I M

1. Kërkohej nga grupet parlamentare që deri në mbledhjen e radhës të Kryesisë t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit Hetimor Parlamentar sipas propozimit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, mbështetur edhe nga deputetët tjerë nënshkrues për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq më 29 mars 2018.

2. Përbërja e komisionit do të jetë me 11 anëtarë: grupet parlamentare të LDK-së, të LVV-së dhe PSD-së, propozojnë pesë (5) anëtarë, si dhe grupet parlamentare të PDK-së, AAK-së, Listës serbe, Nisma Socialdemokrate dhe "6+" propozojnë gjashtë (6) anëtarë.

3. Kryesuesi zgjidhet nga radhët e njërit grup parlamentar, i cili nuk është iniciator i komisionit hetimor dhe nuk i përket partisë së koalicionit qeverisës, përkatësisht nga GP i LVV-së, ndërsa zëvendëskryesuesi emërohet nga radhët e grupit të deputetëve iniciues, përkatësisht nga GP i LDK-së.

*10. Kërkesa e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për debat parlamentar në lidhje me të drejtat e punëtorëve dhe adresimin e papunësisë në Republikën e Kosovës*

Kryesia e radhiti kërkesën e lartshënuar në rend dite të seancës plenare më 17 maj 2018.

*11. Kërkesa e deputetit Visar Ymeri, mbështetur edhe nga 11 deputetë tjerë nënshkrues për debat parlamentar, në lidhje me zbatimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, konkretisht unifikimit të pikave doganore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës*

Kryesia e radhiti kërkesën e lartshënuar në rend dite të seancës plenare më 17 maj 2018.

*12. Kërkesa e deputetit Faton Topalli, mbështetur edhe nga 11 deputetë tjerë nënshkrues për debat parlamentar, në lidhje me Kartonin e Gjelbër*

Kryesia e radhiti kërkesën e lartshënuar në rend dite të seancës plenare më 17 maj 2018.

*13. Kërkesa e deputetit Fidan Rekalii, mbështetur edhe nga 5 deputetë tjerë nënshkrues për debat parlamentar në lidhje me gjendjen jo të mirë të rinisë kosovare*

Kryesia e radhiti kërkesën e lartshënuar në rend dite të seancës plenare më 17 maj 2018.

*14. Kërkesat e grupeve parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Partisë Socialdemokrate lidhur me rindarjen e komisioneve parlamentare të Kuvendit*

Kryetarët e grupeve parlamentare të LVV-së dhe PSD-së, Glauk Konjufca dhe Dardan Sejdiu, i arsyetuan kërkesat e tyre lidhur me rindarjen e komisioneve parlamentare, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Lidhur me kërkesat e lartshënuara, diskutuan: kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli dhe nënkryetarja e Kuvendit, znj. Aida Dërguti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari konstatoi se grupet parlamentare të LVV-së dhe PSD-së, nëse deri në seancën plenare më 17 maj 2018, nuk i procedojnë propozimet e tyre për anëtarë dhe kryetarë të komisioneve parlamentare, atëherë kërkesat e tyre do të shqyrtohen përsëri në mbledhjen e radhës të Kryesisë së Kuvendit.

*15. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Integritet Evropian për ndryshimin e Vendimit të Kryesisë së Kuvendit lidhur me udhëtimin zyrtar në Luksemburg, prej 1-4 maj 2018*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

#### V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 06-V-147, datë 19. 4. 2018.

Ndryshohet dhe plotësohet pika dy (2) e Vendimit nr. 06-V-147, datë 19. 4. 2018, si në vijim: shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit me tejkalim bazuar në faturat, si dhe mëditjet mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

*16. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Naser Rugova për lejimin e udhëtimit zyrtar në Berlin (Gjermani)*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:



## V E N D I M

Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Naser Rugova, i lejohet udhëtimi zyrtar në Berlin (Gjermani), prej 14-16 qershor 2018.

*17. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Buxhet dhe Financa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Vjenë (Austri)*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Lumir Abdixhiku, Mërgim Lushtaku, Blerim Kuçi dhe Dardan Sejdiu u lejohet udhëtimi zyrtar në Vjenë (Austri), prej 10-qershor 2018.

*18. Shqyrtimi i kërkesës së ish-deputetit të Kuvendit të Kosovës, z. Kujtim Paçaku, për mbështetje financiare*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Z. Kujtim Paçaku, ish-deputet i Kuvendit të Kosovës, mbështetet financiarisht në shumën prej 4,999.00 euro për trajtimin shëndetësor të tij.

*19. Shqyrtimi i kërkesës së OJQ-së SOS fshatrat e fëmijëve të Kosovës për mbështetje financiare*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

OJQ “SOS fshatrat e fëmijëve të Kosovës” mbështetet financiarisht në shumën prej 4,999.00 euro për organizimin e aktiviteteve verore në Shqipëri me fëmijët që janë në përkujdesje nga kjo OJQ.

\* \* \*

### **Pikat shtesë:**

*1. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Gani Dreshaj për lejimin e udhëtimit zyrtar në Sofje (Bullgari)*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gani Dreshaj, i konfirmohet lejimi i udhëtimit zyrtar në Sofje (Bullgari), prej 13 deri më 15 maj 2018.

*2. Shqyrtimi i kërkesës së kryetares së Komisionit për Integritet Evropian, Blerta Deliu-Kodra për lejimin e udhëtimit zyrtar në Tiranë (Shqipëri)*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Kryetares së Komisionit për Integritet Evropian, znj. Blerta Deliu-Kodra, i lejohet udhëtimi zyrtar në Tiranë (Shqipëri), prej 25-27 maj 2018.

*3. Njoftimi i kryetarit të Grupit Parlamentar Deputetët e Pavarur, z. Dardan Sejdiu, për ndryshimin e merit të këtij grupi*

Kryesia e Kuvendit u informua me shkrim nga kryetari i GP Deputetët e Pavarur për ndryshimin e emrit të këtij Grupi Parlamentar, nga Grupi i Deputetëve të Pavarur në Grupin Parlamentar të Partisë Socialdemokrate.

*4. Shqyrtimi i kërkesës për mbulim të shpenzimeve lidhur me anulimin e udhëtimit zyrtar për në Kanada*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve në shumën prej 4,961.08 euro për anulimin e udhëtimit zyrtar të paraparë për në Kanada.

*5. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës për formim të grupit të lobimit për anëtarësim në Interpol*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Deputetët e Kuvendi i Republikës së Kosovës, Elmi Reçica dhe Rexhep Selimi, caktohen që në koordinim me Qeverinë e Republikës së Kosovës të llojnë për anëtarësimin e Kosovës në Organizatën Ndërkombëtare të Policisë - Interpol.

*6. Kërkesa e nënkryetarit të Kuvendit, z. Slavko Simiq, për lejimin e pagesës të faturave*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Miratohet kërkesa e nënkryetarit të Kuvendit, z. Slavko Simiq, për lejimin e pagesës në shumën prej 325,50 euro, sipas faturave të bashkangjitura në kërkesën me nr. 06/1296/Do-714.

*7. Propozimi i Kryetarit të Kuvendit, z. Kadri Veseli, për themelimin e Zyrës së Seksionit Frankofon në Kuvendin e Kosovës*

Kryesia, lidhur me propozimi e lartshënuar, mori këtë:

## V E N D I M

Kuvendi i Republikës së Kosovës e themelon Zyrën e Seksionit Frankofon në këtë përbërje: deputetët Haxhi Shala dhe Sami Kurteshi, si dhe një zyrtar nga Drejtoria për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, që duhet ta njohin gjuhën frënge.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 12:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit

**Kadri VESELI**

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale*